Në dhjetë vitet e fundit, është realizuar një numër i madh hulumtimesh dhe raporte reference, në Mal të Zi, të cilat kishin të bënin me marrëdhëniet etnike dhe me distancën etnike. Secila prej këtyre hulumtimeve, zgjeroi horizontin dhe informacionin kur bëhet fjalë për përmasat dhe faktorët të cilët ndikojnë në distancën etnike. CEDEM ka kryer hulumtime tradicionale mbi distancën etnike që prej vitit 2007, dhe të dhënat ishin tregues të shkëlqyeshëm dhe preçize të marrëdhënieve etnike në Mal të Zi, një mjedis që është në thelb multietnik në të gjitha aspektet. Një nga karakteristikat e Malit të Zi, megjithëse nuk është si vendet e mëdha me të gjitha karakteristikat sasiore, është specifik për mjediset lokale. Secila bashki në Mal të Zi, në një farë mënyre, është specifik në karakteristikat e tij kulturore, sociale, etnike madje edhe politike. Kur kryhen hulumtime për matjen e distancës etnike dhe marrëdhëniet etnike, në përgjithësi, dizajnohen mostrat përfaqësuese të cilat duhet të tregojnë matjet në nivelin e të gjithë Malit të Zi. Këto hulumtime përfshijnë jo numër shumë të madh anketuesish nga bashkitë individuale (me përjashtim të Podgoricës), dhe pasqyra e bashkive në këtë drejtim është sigurisht e pamjaftueshme. Nga ana tjetër, në këtë hulumtim, dhe kjo është thelbësore, llogariten faktorët që janë me karakter bashkiak, dhe jo individual. Për shembull, nga ky hulumtimi kuptojmë se, sa më shumë njerëzit janë individualisht të arsimuar, aq më pak etnikisht distancohen, por nuk e dimë nëse niveli mesatar i arsimit në një bashki ndikon në distancën etnike individuale, dhe nëse po, në çfarë mase. Ne gjithashtu dimë se individët me të ardhura më të mëdha distancohen më pak, por nuk e dimë nëse të ardhurat mesatare për bashki ndikojnë tek individët që jetojnë në mjedise të ndryshme nëse distancohen pak a shumë. Këto ishin arsyet kryesore që motivuan këtë hulumtim. Së pari, CEDEM disponon një bazë të dhënash gjatësore për distancimin etnik të individëve pothuajse në të gjitha bashkitë malazeze, me një numër total prej 4163 të anketuar. Kjo do të thotë që ne jemi në gjendje në përmasa të mëdha, që saktësisht të masim karakteristikat e secilit shtetas në efektin e distancimin etnik. Për më tepër, ekzistojnë pak a shumë statistika të besueshme që ofrojnë të dhëna në nivelin bashkiak. Për shembull, dimë numrin e të papunëve për çdo bashki, siç edhe dimë të ardhurat mesatare, moshën mesatare, numrin e arsimimit kompjuterik, etj. Si rrjedhim, këto të dhëna agregate nga bashkitë janë të integruara me të dhënat të cilat Cedem disponon bazuar në hulumtim, dhe u formua një skedar i cili përmban variabla në dy nivele, me qëllimin që të provohet efekti i bashkive dhe karakteristikat e tyre në distancimin etnik. Metodologjikisht, me të dhënat e integruara dhe të organizuara në mënyrën e thënë si më sipër,

kemi operuar me metoda dhe teknika komplekse statistikore për të identifikuar efektin e bashkive në distancimin etnik.

Statistikisht, llogaritja nënkupton faktin se individët nuk kanë jo vetëm karakteristika personale, por tashmë ato janë të vendosur në bashkitë e tyre, dhe këta me të njëjtat karakteristika individuale mund të kenë efekte të ndryshme në ambiente të ndryshme. Për shembull, kur masim të ardhurat e të anketuarve gjatë hulumtimit, kemi të dhëna për të ardhurat personale të të gjithë të anketuarve, dhe mund të llogarisim efektin e të ardhurave individuale në distancimin etnik. Sidoqoftë, në praktikë, mund të jetë që dikush të ketë të ardhura 300 euro, por jeton në një bashki ku mesatarja është 500 euro, ose në një bashki ku të ardhurat mesatare janë 200 euro.

Me fjalë të tjera, efekti i të njëjtit nivel të të ardhurave mund të jetë i ndryshëm duke pasur parasysh karakteristikat e bashkisë në të cilën jeton individi. Këto ishin aspektet që kemi pasur në mendje, dhe procedurat që kemi kryer me qëllimin e matjes së efektit të një mjedisi specifik bashkiak në distancimin etnik. Raporti ka mjaft metoda dhe teknika komplekse statistikore, por ne i kemi përshtatur rezultatet e hulumtimit tek lexuesit dhe vendimmarrësit që nuk kanë nevojë të kenë njohuri të veçanta statistikore për të kuptuar të dhënat, dhe t'i përdorin ato në praktikën e punës.

Raporti është përgatitur në kuadër të projektit “**Forcimi i sistemit për një shoqëri me të drejta të barabarta**” të cilin Qendra për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut - CEDEM realizon me mbështetjen e **Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave**. Analiza pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e Qendrës për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut dhe autorit të Analizës, dhe jo domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve.


Efeki i analizave thelbesore dhe ndryshimet midis bashkive

Së pari, distancimi etnik varet nga karakteristikat individuale të njerëzve që jetojnë në atë bashki, por edhe nga karakteristikat e përgjithshme të bashkive. Prandaj, ne së pari llogaritëm se në çfarë mase distanca etnike varet nga këto karakteristika individuale, dhe në çfarë mase nga karakteristikat e bashkive. Për këtë qëllim, përdoret i ashtëquajtëri koeficienti i korrelacionit intraklas (ICC), ndërsa rezultati i efektit mund të vërehen në tabelën nr.1. Për të sqaruar rezultatet e matjes, të dhënat e njejta paraqiten si përqindje në grafikun nr. 1. **Të dhënat tregojnë se bashkitë, si mjedise specifike, kanë një efekt të fortë në distancimin etnik.** Në masën më të madhe, efekti i bashkësisë theksohet kur bëhet fjalë për distancimin etnik kundrejt atyre që deklarojnë veten si serb, më saktë, gati 25% e distancimit nga ky grup etnik varet nga bashkitë në të cilën jetojnë personat, dhe jo nga karakteristikat personale. Ka një përqindje të lartë në këtë drejtim kur bëhet fjalë për malazezët. Pra, edhe kur bëhet fjalë për këtë grup etnik, mbi 20% e distancës varet nga bashkia, dhe jo nga karakteristikat personale të njerëzve. Për grupet e tjera etnike, përqindjet janë më të ulëta, por gjithsesi mjaftueshëm të larta për të thënë se, kjo varet nga bashkia në të cilën njerëzit jetojnë në një masë të madhe, varet nga fakti nëse individët do të shprehin distancën etnike në një masë më të madhe ose më të vogël.

Tabela 1: Koeficienti i korrelacionit intraklas: efekti i bashkive në distancimin etnik


	ICC
Distanca ndaj malazezëve	0.211
Distanca ndaj serbëve	0.246
Distanca ndaj boshnjakëve	0.085
Distanca ndaj myslimanëve	0.141
Distanca ndaj shqiptarëve	0.163
Distanca ndaj kroatëve	0.188
Distanca ndaj romëve	0.101
Distanca totale	0.140

Grafiku nr.1: Efekti i bashkive në distancimin etnik %




Në grafikun i cili vijon, paraqesim distancën etnike të bashkive kundrejt çdo grupi etnik. Plotësisht është e qartë se të dhënat varen shumë nga struktura etnike e qytetarëve në bashkitë e referuara. Sidoqoftë, të dhënat për distancën totale janë sigurisht indikative **dhe tregojnë nevojën për t'i kushtuar vëmendje të veçantë zonave të caktuara në mënyrë që të zvogëlohet distanca etnike dhe të përmirësohen marrëdhëniet etnike**. Bashkitë me shkallën më të lartë të distancimit etnik janë Plavë, Shavnik, Andrijevicë dhe Beranë. Në të gjitha këto mjedise, distanca shprehet drejt grupeve të ndryshme, por përgjithësisht ekziston një nivel i lartë distancimi.


Grafiku nr.2: Distanca ndaj malazezëve sipas bashkive




Grafiku nr.3: Distanca ndaj serbëve sipas bashkive




Grafiku nr.4: Distanca etnike ndaj boshnjakëve sipas bashkësive




Grafiku nr.5: Distanca etnike ndaj myslimanëve sipas bashkive




Grafiku nr.6: Distanca etnike ndaj shqiptarëve sipas bashkive




Grafiku nr.7: Distanca etnik ndaj kroatëve sipas bashkive



Grafiku nr.8: Distanca etnike ndaj romëve sipas bashkive



Grafiku nr.9: Distanca totale sipas bashkive




ALB


Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distancimi etnik

Karakteristika e parë e bashkive të cilën kemi analizuar është përqindja e popullsisë ekonomiksht aktive sipas bashkive. Kështu, kemi matur efektin e kësaj karakteristike në distancimin etnik. Në grafikët e mëposhtëm së pari jepet pamja e marrëdhënieve midis përqindjes së popullsisë ekonomiksht aktive dhe distancës ndaj secilit grup etnik, si dhe distancës totale.


Grafiku nr.10: Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distanca ndaj malazezëve




Grafiku nr.11: Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distanca ndaj serbëve




Grafiku nr.12: Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distanca ndaj boshnjakëve



Grafiku nr.13: Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distanca ndaj myslimanëve




Grafiku nr.14: Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distanca ndaj shqiptarëve




ALB


Grafiku nr.15: Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distanca ndaj kroatëve



Grafiku nr.16: Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distanca ndaj romëve



Grafiku nr.17: Aktiviteti ekonomik i popullsisë dhe distanca totale



Në tabelën nr.2 jepet saktësisht i matur në përqindje efekti i popullsisë ekonomkisht aktive në distancimin etnik të individëve. Rezultatet tregojnë se përqindja e popullsisë ekonomkisht aktive sipas bashkive ndikon në nivelin e distancimit etnik kur bëhet fjalë për distancën ndaj malazezëve, serbëve, boshnjakëve dhe myslimanëve. Sidoqoftë, interesante është që efekti nuk është uniform. Ekzaktësisht, vërtetuar se rritja e numrit të popullsisë ekonomkisht aktivë sipas bashkive, zvogëlon nivelin e distancës etnike ndaj malazezëve dhe serbëve, por rritet drejt boshnjakëve dhe myslimanëve. Akoma më saktë, nëse rritet me një përqind aktiviteti ekonomik i popullatës në bashki, distanca etnike ndaj malazezëve do të ulet rreth 1%, dhe drejt serbëve rreth 1.3%. Nga ana tjetër, nëse përqindja e popullsisë ekonomkisht aktive rritet me 1%, distancimi etnik nga boshnjakët dhe myslimanët do të rritet me 1%. Të dhënat janë indikative dhe interesante, dhe lind pyetja se pse një numër më i madh i popullatës ekonomkisht aktive rrit distancimin etnik nga myslimanët dhe boshnjakët. Si përfundim, përqindja e popullsisë ekonomkisht aktive nuk ndikon në shkallën e distancimit etnik ndaj grupeve të tjera etnike.


Tabela nr. 2: Aktiviteti ekonomik i popullsisë sipas bashkive dhe distanca etnike

	DISTANCA NDAJ							
	Malazezëve	Serbëve	Boshnjakëve	Myslimanëve	Shqiptarëve	Kroatëve	Romëve	Totali
Intercept	,472***	,746	,030	-,123	,575**	1,08***	,785***	,604***
Gjinia	-,009	-,010	-,037***	-,040**	-,008	-0,02	,000	-,016*
Mosha	,000	-,001***	,000	,000	,000	0,00	,001***	,000
Arsimi	-,010***	-,018***	-,020***	-,020**	-,026***	-0,03***	-,027***	-,022***
Të ardhurat	-,003***	-,002	-,003	-,009***	-,001	-0,01***	,003	-,002
Malazez	-,026**	-,043***	-,025	,224***	,022	-0,02	,075***	-,006
Serbë	,004	-,061***	,189***	,414***	,296***	0,25***	,221***	,150***
Shqiptarë	,077**	,235***	,072***	,249***	-,331***	-0,02	,232***	,033*
Boshnjakë	,069**	,101***	-,193***	,039	,012	-0,01	,062	-,032
Mysliman	,046**	,117***	-,172***	,008	,029	0,11***	,109***	-,007
Aktiviteti ekonomik i popullsisë	-,009**	-,013**	,010**	,010**	-,001	-0,01	-,008	-,005


Subjektet aktive të biznesit dhe distancimi etnik

Karakteristikë tjetër e bashkisë e cila ishte subjekti i interesit tonë është efekti i numrit të subjekteve aktive të biznesit në bashki si një faktor i distancimit etnik. Ky tregues, si ai i mëparshmi, u takon treguesve ekonomikë, dhe në të vërtetë, mat shkallën e aktivitetit ekonomik të bashkive. Në grafikët që vijojnë, ne matim efektin e numrit të subjekteve aktive të biznesit në distancimin etnik, për secilin grup etnik, individualisht.


Grafiku nr.18: Subjektet aktive të biznesit dhe distanca ndaj malazezëve




Grafiku nr.19: Subjektet aktive të biznesit dhe distanca ndaj serbëve



Grafiku nr.20: Subjektet aktive të biznesit dhe distanca ndaj boshnjakëve




Grafiku nr.21: Subjektet aktive të biznesit dhe distanca ndaj myslimanëve




Grafiku nr.22: Subjektet aktive të biznesit dhe distanca ndaj shqiptarëve


ALB




Grafiku nr.23: Subjektet aktive të biznesit dhe distanca ndaj kroatëve



Grafiku nr.24: Subjektet aktive të biznesit dhe distanca ndaj romëve



Grafiku nr.25: Subjektet aktive të biznesit dhe distanca totale



ALB

Në tabelën nr.3 tregohet efekti i numrit të subjekteve aktive të biznesit në distancimin etnik. Të dhënat tregojnë se numri i subjekteve aktive të biznesit sipas bashkive nuk ndikon në distancën etnike drejt kujdoqftë grupi etnik.


Tabela nr.3: Numri i subjekteve aktive të biznesit sipas bashkive dhe distancimi etnik

	DISTANCA NDAJ							Totali
	Malazezëve	Serbëve	Boshnjakëve	Myslimanëve	Shqiptarëve	Kroatëve	Romëve	
Intercept	,176***	,291***	,385***	,217***	,585***	,670***	,541***	,439***
Gjinia	-,009	-,010	-,036***	-,040**	-,008	-,020	,000	-,015*
Mosha	,000	-,001**	,000	,000	,000	,000	,001***	,000
Arsimi	-,010***	-,018***	-,020***	-,020**	-,026***	-,034***	-,027***	-,022***
Të ardhurat	-,003***	-,003*	-,003	-,009***	-,001	-,007***	,003	-,002
Malazez	-,027**	-,043***	-,025	,223***	,022	-,019	,074***	-,006
Serbë	,004	-,062***	,189***	,413***	,296***	,247***	,220***	,150***
Shqiptarë	,079***	,237***	,070**	,240***	-,332***	-,015	,234***	,034*
Boshnjakë	,071***	,103***	-,196***	,023	,010	-,010	,063	-,031
Mysliman	,047**	,118***	-,175***	-,004	,028	,108**	,110**	-,007
Subjektet aktive të biznesit	-,005	-,006	,001	,007	-,007	-,013	-,009	-,006


Paga mesatare dhe distancimi etnik

Karakteristika tjetër e bashkisë që kemi analizuar si faktor potencial të distancimit etnik është paga mesatare që karakterizon bashkitë. Të dhënat ishin potencialisht të rëndësishme duke pasur parasysh faktin se të ardhurat personale, të cilat i vërtetuan në hulumtimet e mëparshme, ndikojnë ndjeshëm në shkallën e distancimit etnik individual. Më saktësisht, kemi zbuluar se me rritjen e të ardhurave personale, shkalla e distancimit etnik zvogëlohet. Pra, supozimi ishte se me rritjen e shkallës mesatare e të ardhurave të bashkive, zvogelojmë shkallën e distancimit individual. Në grafikët që vijojnë, së pari japim një përmbledhje të distancës etnike ndaj të gjitha grupeve etnike dhe pagave mesatare në të gjitha bashkitë.


Grafiku nr.26: Paga mesatare dhe distanca ndaj malazezëve




Grafiku nr.27: Paga mesatare dhe distanca ndaj serbëve




Grafiku nr.28: Paga mestare dhe distanca ndaj boshnjakëve




Grafiku nr.29: Paga mestare dhe distanca ndaj myslimanëve




Grafiku nr.30: Paga mestare dhe distanca ndaj shqiptarëve




Grafiku nr 31: Paga mestare dhe distanca ndaj kroatëve



Grafiku nr.32: Paga mesatare dhe distanca ndaj romëve



Grafiku nr.33: Paga mestare dhe distanca totale



Në tabelën nr. 4, ne kemi llogaritur saktësisht efektin e pagës mesatare të bashkive në distancën etnike ndaj anëtarëve të të gjitha grupeve, si dhe efektin në distancën totale etnike. Të dhënat nuk janë në përputhje me pritshmërinë, më saktë, kemi konstatuar se vetëm kur bëhet fjalë për distancën ndaj myslimanëve, mund të presim një shkallë më të madhe distance ndaj anëtarëve të këtij grupi etnik në bashkitë, ku paga mesatare është më e lartë. Në të gjitha rastet e tjera, nuk kemi zbuluar ndonjë efekt të rëndësishëm të të ardhurave mesatare në bashki për sa i perket distancimit etnik.


Tabela nr.4: Paga mesatare dhe distanca etnike ndaj të gjithë grupeve

	DISTANCA NDAJ							
	Malazezëve	Serbëve	Boshnjakëve	Myslimanëve	Shqiptarëve	Kroatëve	Romëve	Totali
Intercept	,220	,514	,080	-,439**	,418	,791*	,678*	,442*
Gjinia	-,009	-,010	-,036***	-,041**	-,008	-,020	-,001	-,016*
Mosha	,000	-,001	,000	,000	,000	,000	,001***	,000
Arsimi	-,010***	-,018***	-,020***	-,020**	-,026***	-,034***	-,027***	-,022***
Të ardhurat	-,003***	-,003**	-,003	-,009***	-,001	-,007***	,003	-,002*
Malazez	-,027**	-,043***	-,025	,228***	,022	-,019	,074***	-,006
Serbë	,004	-,061***	,189***	,418***	,296***	,247***	,221***	,150***
Shqiptarë	,079***	,236***	,072**	,249***	-,330***	-,015	,233***	,034*
Boshnjakë	,071***	,103***	-,196***	,033	,012	-,009	,065	-,030
Mysliman	,047**	,118***	-,174***	,005	,030	,109***	,111**	-,006
Paga mesatare	,000	-,001	,001	,001***	,000	,000	,000	,000


Përqindja e papunësisë dhe distancimi etnik

Një karakteristikë tjetër e bashkive që ishte objekt i interesit tonë , është përqindja e të papunëve sipas bashkive, më saktë, supozimi se nga kjo përqindje varet edhe shkalla e distancimit individual. Supozimi është i vlefshëm për dy arsye, së pari, në nivelin individual, papunësia është një nga faktorët e distancimit etnik, dhe e dyta, është teorikisht e njohur që papunësia rrit nivelin e zhgënjimit, i cili rrjedhimisht mund të përshkallëzohet në agresion kundër pakicave. Në grafikët që pasojnë, së pari japim një përmbledhje të shkallës së papunësisë dhe distancës etnike ndaj të gjitha grupeve etnike në të gjitha bashkive.


Grafiku nr.34 : Papunësia dhe distanca ndaj malazezëve




Grafiku nr.35: Papunësia dhe distanca ndaj serbëve




Grafiku nr.36: Papunësia dhe distanca ndaj boshnjakëve



Grafiku nr.37: Papunësia dhe distancandaj myslimanëve




Grafiku nr.38: Papunësia dhe distanca ndaj shqiptarëve




ALB


Grafiku nr.39: Papunësia dhe distanca ndaj kroatëve



Grafiku nr.40: Papunësia dhe distanca ndaj romëve



Grafiku nr.41: Papunësia dhe distanca totale



Në tabelën japim treguesin e efektit të shkallës së papunësisë në distancimin etnik ndaj anëtarëve të të gjitha grupeve etnike. Të dhënat tregojnë se rritja e shkallës së papunësisë ndikon në shkallën e distancimit etnik ndaj malazezëve dhe serbëve. Prandaj, sa më i lartë niveli i papunësisë në bashki, aq më i lartë pritet shkalla e distancimit etnik ndaj anëtarëve të këtyre dy grupeve etnike. Për shkak të këtij efekti, të papunësisë në të dy grupet etnike dominuese, ne gjithashtu matim efektin e papunësisë në nivelin e përgjithshëm të distancimit etnik. Megjithatë, shkalla e papunësisë në bashki nuk ndikon në shkallën e distancimit etnik nga anëtarët e grupeve etnike minoritare.


Tabela nr.5: Papunësia dhe distanca etnike

DISTANCA NDAJ								
	Malazezëve	Serbëve	Boshnjakëve	Myslimanëve	Shqiptarëve	Kroatëve	Romëve	Totali
Intercept	,002	,072	,467***	,305***	,452***	,327***	,396***	,287***
Gjinia	-,008	-,010	-,037***	-,040**	-,008	-,020	,000	-,015*
Mosha	,000	-,001**	,000	,000	,000	,000	,001***	,000
Arsimi	-,010***	-,017***	-,020***	-,021**	-,026***	-,034***	-,027***	-,022***
Të ardhurat	-,003***	-,002	-,003	-,009***	-,001	-,007***	,003	-,002
Malazez	-,027**	-,043***	-,025	,222***	,022	-,018	,074***	-,006
Serbë	,004	-,061***	,189***	,411***	,297***	,247***	,221***	,150***
Shqiptarë	,080***	,240***	,069**	,239***	-,331***	-,013	,236***	,035*
Boshnjakë	,069***	,101***	-,195***	,023	,009	-,014	,063	-,033
Mysliman	,046**	,117***	-,174***	-,005	,028	,106**	,110**	-,008
Papunësia	,015**	,019**	-,008	-,005	,009	,027	,010	,012*


Përqindja e arsimit dhe distancimi etnik

Analiza e të dhënave të sondazhit gjithmonë tregon, se arsimi është një faktor i rëndësishëm i distancimit etnik në nivel individual. Prandaj, kemi testuar nëse dhe në çfarë mase përqindja e arsimit të lartë në bashkitë e Malit të Zi, potencialisht varet nga shkalla e distancimit etnik të individëve në lidhje me anëtarët e grupeve të tjera etnike. Së pari, në grafikët që vijojnë jepen treguesit e përqindjes së të papunëve dhe shkalla e distancimit etnik.


Grafiku nr.42: Përqindja e arsimit të lartë dhe distanca ndaj malazezëve




Grafiku nr.43: Përqindja e arsimit të lartë dhe distanca ndaj serbëve




Grafiku nr.44: Përqindja e arsimit të lartë dhe distanca ndaj boshnjakëve




Grafiku nr.46: Përqindja e arsimit të lartë dhe distanca ndaj Myslimanëve




Grafiku nr.46: Përqindja e arsimit të lartë dhe distanca ndaj shqiptarëve




Grafiku nr.47: Përqindja e arsimit të lartë dhe distanca ndaj kroatëve



Grafiku nr.48: Përqindja e arsimit të lartë dhe distanca ndaj romëve



Grafiku nr.49: Përqindja e arsimit të lartë dhe distanca totale



Në tabelën nr. 6 jepet treguesi i përqindjes të personave me arsim të lartë sipas bashkive në distancimin etnik. Rezultatet e matjeve nuk janë në përputhje me pritshmërinë, që do të thotë se, ato tregojnë se përqindja e arsimit të lartë i bashkive zvogëlon shkallën e distancimit etnik individual vetëm kur bëhet fjalë për kroatët. Prandaj, sa më i lartë numri i njerëzve me arsim të lartë i bashkive, aq më i ulët do jet shkalla e distancimit etnik nga kroatët. Kur bëhet fjalë për distancimin etnik nga anëtarët e të gjitha grupeve të tjera, ne nuk kemi identifikuar rëndësinë e arsimit mesatar nga bashkitë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh që arsimit individual është një nga faktorët kryesorë të distancimit etnik, ne konkludojmë se shkalla e distancimit etnik varet kryesisht nga niveli i edukimit personal, dhe kjo është ndoshta arsyeja kryesore pse niveli mesatar i arsimit në bashki, nuk luan një rol veçanërisht të rëndësishëm.


Tabela nr.6: përqindja e arsimit të lartë dhe distancimi etnik

	DISTANCA NDAJ							
	Malazezëve	Serbëve	Boshnjakëve	Myslimanëve	Shqiptarëve	Kroatëve	Romëve	Totali
Intercept	,233***	,369***	,307***	,158	,635***	,813**	,563***	,483***
Gjinia	-,009	-,010	-,037***	-,040**	-,008	-,020	-,001	-,016*
Mosha	,000	-,001***	,000	,000	,000	,000	,001***	,000
Arsimi	-,010***	-,018***	-,020***	-,020**	-,026***	-,034***	-,027***	-,022***
Të ardhurat	-,003***	-,002*	-,003	-,009***	-,001	-,007***	,003	-,002
Malazez	-,026**	-,043***	-,025	,223***	,022	-,018	,074***	-,006
Serbë	,004	-,061***	,189***	,413***	,297***	,247***	,221***	,150***
Shqiptarë	,079***	,237***	,070**	,243***	-,332***	-,016	,234***	,033*
Boshnjakë	,070***	,102***	-,195***	,028	,010	-,012	,064	-,031
Mysliman	,046***	,118***	-,174***	-,001	,028	,107**	,110**	-,007
Arsimit i lartë	-,011	-,015	,011	,013	-,012	-,029*	-,010	-,011


Përqindja e individëve me arsim kompjuterik dhe distancimi etnik

Sot, përveç arsimit, si një tregues i rëndësishëm i kapitalit kulturor merret numri i individëve me arsim kompjuterik. Prandaj, përveç arsimit si faktor potencial, kemi matur edhe efektin e individëve me arsim kompjuterik të bashkive ndaj distancimit etnik. Pritshmërit ishin që me rritjen e numrit të individëve me arsim kompjuterik të bashkive, shkalla e distancimit etnik individual do të zvogëlohej. Së pari, në grafikët që vijojnë, ne japim një përmbledhje të numrit të individëve me arsim kompjuterik të bashkive dhe shkallën e distancimit etnik.


Grafiku nr. 50: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distanca ndaj malazezëve




Grafiku nr.51: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distanca ndaj serbëve




Grafiku nr.52: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distanca ndaj boshnjakëve




Grafiku nr.53: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distanca ndaj myslimanëve




Grafiku nr.54: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distanca ndaj shqiptarëve




Grafiku nr.55: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distanca ndaj kroatëve



Grafiku nr.56: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distanca ndaj romëve



Grafiku nr.57: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distanca totale



Në tabelën nr.7 kemi matur saktësisht efektin e numrit të individëve me arsim kompjuterik në shkallën e distancimit etnik. Të dhënat tregojnë se ky numër ka potencialin të jetë një faktor mbrojtës i distancimit etnik. Më saktësisht, kemi zbuluar se me rritjen e numrit të individëve me arsim kompjuterik të bashkive, shkalla e distancimit etnik ndaj malazezëve, serbëve dhe kroatëve zvogëlohet. Si pasojë, kemi zbuluar se me rritjen e numrit të individëve me arsim kompjuterik, mund të presim uljen e shkallës së distancimit të përgjithshëm etnik.


Tabela nr.7: Numri i individëve me arsim kompjuterik dhe distancimi etnik

DISTANCA NDAJ								
	Malazezëve	Serbëve	Boshnjakëve	Myslimanëve	Shqiptarëve	Kroatëve	Romëve	Totali
Intercept	,319***	,478***	,293**	,107	,708***	1,031***	,670***	,577***
Gjinia	-,008	-,010	-,037***	-,040**	-,008	-,020	,000	-,015*
Mosha	,000	-,001**	,000	,000	,000	,000	,001***	,000
Arsimi	-,010***	-,017***	-,020***	-,021**	-,026***	-,034***	-,027***	-,022***
Të ardhurat	-,003***	-,002	-,003	-,009***	-,001	-,007***	,003	-,002
Malazez	-,026**	-,043***	-,025	,223***	,022	-,018	,075***	-,006
Serbë	,004	-,061***	,189***	,413***	,297***	,247***	,221***	,150***
Shqiptarë	,078***	,237***	,070**	,243***	-,333***	-,018	,234***	,033*
Boshnjakë	,070***	,102***	-,195***	,029	,009	-,015	,062	-,032
Mysliman	,046**	,118***	-,174***	,000	,027	,106**	,109	-,008
Arsimi kompjuterik	-,013**	-,017**	,007	,011	-,012	-,033***	-,013	-,013*


Përqindja e popullsisë urbane dhe distancimi etnik

Aspekti tjetër, pra karakteristikat e bashkive që kemi testuar, ekziston efekti i përqindjes së popullsisë urbane në distancimin etnik. Duke pasur parasysh që ekzistojnë dallime të konsiderueshme kulturore midis zonave urbane dhe rurale, ishte e arsyeshme pritshmëria se përqindja e popullsisë urbane sipas bashkive, zvogëlon potencialisht shkallën e distancimit etnik individual. Në grafikët që vijojnë, së pari japim një përmbledhje të distancës etnike ndaj secilit grup etnik individualisht për të gjitha bashkitë në Mal të Zi.


Grafiku nr.58: Përqindja e popullsisë urbane dhe distanca ndaj malazezëve




Grafiku nr.59: Përqindja e popullsisë urbane dhe distanca ndaj serbëve




Grafiku nr.60: Përqindja e popullsisë urabane dhe distanca ndaj boshnjakëve



Grafiku nr.61: Përqindja e popullsisë urbane dhe distanca ndaj myslimanëve




Grafiku nr.62: Përqindja e popullsisë urbane dhe distanca ndaj shqiptarëve




ALB

Grafiku nr.63: Përqindja e popullsisë urbane dhe distanca ndaj kroatëve



Grafiku nr.64: Përqindja e popullsisë urbane dhe distanca ndaj romëve



Grafiku nr.65: Përqindja e popullsisë urbane dhe distanca totale




Tabela 8 tregon efektin e përqindjes së popullsisë urbane në lidhje me distancimin etnik. Të dhënat tregojnë se vetëm kur bëhet fjalë për myslimanët, vërtetojmë se ekziston efekti i përqindjes së popullsisë urbane. Më saktësisht, kemi zbuluar që nëse mjedisi është më urban, distancimi etnik i individëve nga myslimanët do të jetë në një nivel më të ulët. Në të gjitha situatat e tjera, ne nuk kemi identifikuar efektin e mjedisit urban në distancimin etnik.


Tabela nr.8: Përqindja e popullsisë urbane dhe distancimi etnik.

DISTANCA NDAJ								
	Malazeze	Serbë	Boshnjakë	Myslimanë	Shqiptarë	Kroatë	Romë	Totali
Intercept	,246***	,357***	,273***	,119	,638***	,763***	,530***	,461***
Gjinia	-,009	-,010	-,037***	-,040**	-,008	-,020	-,001	-,016*
Mosha	,000	-,001**	,000	,000	,000	,000	,001***	,000
Arsimi	-,010***	-,018***	-,020***	-,020**	-,026***	-,034***	-,027***	-,022***
Të ardhurat	-,003***	-,003*	-,003	-,009***	-,001	-,007***	,003	-,002
Malazez	-,026**	-,043***	-,026	,221***	,022	-,018	,074***	-,006
Serbë	,004	-,061***	,189***	,414***	,297***	,247***	,221***	,150***
Shqiptarë	,079***	,237***	,069**	,239***	-,332***	-,015	,234***	,034*
Boshnjakë	,070***	,103***	-,195***	,031	,010	-,011	,065	-,031
Mysliman	,046**	,118***	-,173***	,002	,028	,108***	,111**	-,007
Popullsisë urbane	-,002	-,002	,002	,002*	-,002	-,003	-,001	-,001


Mosha mesatare e bashkive dhe distancimi etnik

Karakteristika e fundit e bashkisë e cila ishte objekt i analizës sonë ishte mosha mesatare e bashkive, më saktë, efekti i moshës mesatare të popullsisë në distancimin etnik. Në grafikët që vijojnë, së pari, ne japim një përmbledhje të efektit të moshës mesatare të popullsisë të bashkive në distancën etnike ndaj të gjitha grupeve.


Grafiku nr.66: Mosha mesatare dhe distancimi ndaj malazezëve




Grafiku nr.67: Mosha mesatre dhe distancimi ndaj serbëve




Grafiku nr.68: Moshja mesatare dhe distancimi ndaj boshnjakëve



Grafiku nr.69: Moshja mesatare dhe distancimi ndaj myslimaneve




Grafiku nr.70: Moshja mesatare dhe distancimi ndaj shqiptarëve




ALB

Grafiku nr.71: Mosha mesatare dhe distancimi ndaj kroatëve



Grafiku nr.72: Mosha mesatare dhe distancimi ndaj romëve



Grafiku nr.73: Mosha esatare dhe distanca totale




Tabela nr.9 përmbledh efektin e moshës mesatare në distancimin etnik. Rezultatet e matjes tregojnë se moshja mesatare e bashkive nuk ka ndonjë efekt domethënës në distancën etnike, dhe këto të dhëna janë të vlefshme për të gjitha grupet etnike.

Tabela nr.9: Moshja mesatare e bashkive dhe distancimi etnik

	Malazezëve	Serbëve	Boshnjakëve	Myslimanëve	Shqiptarëve	Kroatëve	Romëve	Totali
Intercept	,409	,680	,314	,044	,778	1,178	,644	,664*
Gjinia	-,009	-,010	-,036***	-,040**	-,008	-,020	-,001	-,016*
Mosha	,000	-,001**	,000	,000	,000	,000	,001***	,000
Arsimi	-,010***	-,018***	-,020***	-,021**	-,026***	-,034***	-,027***	-,022***
Të ardhurat	-,003***	-,003*	-,003	-,009***	-,001	-,007***	,003	-,002
Malazez	-,026**	-,043***	-,025	,221***	,022	-,018	,074***	-,006
Serbë	,004	-,061***	,189***	,410***	,296***	,247***	,221***	,150***
Shqiptarë	,079***	,237***	,070**	,238***	-,331***	-,014	,234***	,034*
Boshnjakë	,071***	,103***	-,196***	,018	,011	-,010	,065	-,030
Mysliman	,047**	,118***	-,175***	-,009	,029	,109***	,111**	-,006
Mosha mesatare	-,007	-,011	,002	,006	-,006	-,015	-,004	-,007

Përmbledhje e distancës etnike sipas parametrave të bashkive

Si përfundim, ne japim një përmbledhje të të gjitha karakteristikave bashkiake për distancimin etnik në tabelën nr.10. Treguesit janë dhënë me synimin të përcaktojnë nëse ka një efekt të secilës prej karakteristikave, dhe nëse është pozitiv apo negativ.

Tabela nr.10: Efekti i karakteristikave të bashkive në distancën etnike

DISTANCA NDAJ								
	Malazezëve	Serbëve	Boshnjakëve	Myslimanëve	Shqiptarëve	Kroatëve	Romëve	Totali
Aktiviteti ekonomikë i popullsisë	-	-	+	+	NE	NE	NE	NE
Subjektet aktive të biznesit	NE	NE	NE	NE	NE	NE	NE	NE
Paga mesatare	NE	NE	NE	+	NE	NE	NE	NE
Papunësia	+	+	NE	NE	NE	NE	NE	+
Arsimit i lartë	NE	NE	NE	NE	NE	-	NE	NE
Arsimi kompjuterik	-	-	NE	NE	NE	-	NE	-
Popullsia urbane	NE	NE	NE	+	NE	NE	NE	NE
Mosha mesatare	NE	NE	NE	NE	NE	NE	NE	NE

+ do të thotë që karakteristika rrit distancimin etnik

- do të thotë që zvogëlon distancimin etnik

JO do të thotë që nuk ka asnjë efekt

Çdo efekt i llogaritur kontrollon nga variablat kryesorë demografikë. Kjo do të thotë që efekti i matur nuk ndikohet nga gjinia, mosha, arsimi, të ardhurat si edhe përkatësia etnike. Për më tepër, duke përdorur modelimin hierarkik linear, saktësisht, u mat efekti në atë mënyrë që të llogaritej efekti i vëzhgimeve të grupimit të bashkive. Rezultatet tregojnë se kur bëhet fjalë për malazezët, ekzistojnë tre karakteristika kryesore të bashkive që ndikojnë në distancimin etnik dhe ato janë:

- Sa më e lartë përqindja e popullatës ekonomike aktive në bashki, aq më e ulët është shkalla e distancimit nga malazezët;
- Sa më i lartë numri i të papunëve në bashki, aq më e lartë është shkalla e distancës etnike ndaj malazezëve

- Sa më i lartë numri i njerëzve me arsim kompjuterik, aq më e ulët është shkalla e distancimit etnik ndaj malazezëve.

Pra, në përgjithësi, me rritjen e aktivitetit ekonomik dhe kapitalit kulturor në nivelin bashkiak, mund të presim një ulje të shkallës së distancës etnike ndaj malazezëve

Kur vjen puna për të distancimin ndaj serbëve, analiza e efektit të të dhëna të përgjithshme nga ana e bashkive tregon pamje të njëjtë si edhe kur është fjala për malazezët. Kështu që:

- Sa më e lartë përqindja e aktivitetit ekonomik i popullsisë në bashki, aq më e ulët është shkalla e distancimit ndaj serbëve
- Sa më i lartë numri i të papunëve në bashki, aq më i madh është shkalla e distancës etnike ndaj serbëve;
- Sa më i lartë numri i individëve me arsim kompjuterik, aq më e ulët është shkalla e distancimit etnik ndaj serbëve

Si pasojë, kur behet fjalë për malazezët, si përfundim themi se me rritjen e aktivitetit ekonomik dhe kapitalit kulturor në nivel bashkie mund të presim uljen e shkallës së distancës etnike ndaj malazezëve

Kur bëhet fjalë për boshnjakët, ne kemi identifikuar një faktor të vetëm në nivelin e bashkive i cili ndikon në shkallën e distancimit etnik nga anëtarët e këtij grupi etnik, dhe kjo është përqindja e popullatës aktive ekonomike. Më saktësisht, ne kemi identifikuar se **me rritjen e përqindjes së popullsisë aktive ekonomike, shkalla e distancimit etnik ndaj boshnjakëve rritet.**

Kur bëhet fjalë për distancimin ndaj muslimanëve, rezultatet e analizës së të dhënave agregate e bashkive tregojnë si më poshtë:

- Sa më e lartë të jetë përqindja e popullatës ekonomike aktive, aq më e madhe është shkalla e distancimit etnik ndaj muslimanëve;
- Sa më e lartë paga mesatare në bashki, aq më i lartë është shkalla e distancimit etnik ndaj muslimanëve
- Sa më e lartë përqindja e popullsisë urbane në bashki, aq më e lartë mund të pritët shkalla e distancimit etnik ndaj muslimanëve.

Kështu, modeli i efektit të karakteristikave bashkiake në distancimin etnik ndaj muslimanëve është pothuajse i kundërt kur krahasohet me efektin e bashkive në dy grupet shumicë, dhe të dhënat tregojnë **se forcimi i statusit ekonomik i bashkive rrit shkallën e distancimit etnik ndaj muslimanëve.**

Kur bëhet fjalë për shqiptarët, asnjë karakteristikë bashkiake nuk ndikon në shkallën e distancimit etnik nga anëtarët e këtij grupi etnik. Arsyeja është se distancimi etnik nga shqiptarët është i ndikuar kryesisht nga karakteristikat individuale të njerëzve, dhe jo nga karakteristikat e bashkive në të cilat ata jetojnë. Më saktësisht, vetë etnia dhe niveli i arsimimit në nivel individual janë karakteristika kryesore që rrisin shkallën e distancimit etnik nga shqiptarët.

Kur bëhet fjalë për distancimin ndaj kroatëve, të dhënat tregojnë si më poshtë:

- Sa më e lartë të jetë përqindja e njerëzve me arsim të lartë në bashki, aq më e ulët është shkalla e distancimit etnik ndaj kroatëve;
- Sa më i lartë numri i individëve me arsim kompjuterik në bashki, aq më e ulët është shkalla e distancimit etnik nga kroatët.

Pra, kur bëhet fjalë për distancimin etnik ndaj kroatëve, konkludojmë se me rritjen e kapitalit kulturor në bashki, mund të presim një ulje të distancës etnike ndaj anëtarëve të këtij grupi etnik.

Kur bëhet fjalë për romët, ashtu si kur kemi thënë për shqiptarët, asnjë nga karakteristikat e bashkisë nuk ndikon në distancën etnike ndaj anëtarëve të këtij grupi etnik. Përsëri, arsyeja është se karakteristikat personale dhe jo ato bashkiake, ndikojnë në distancimin etnik ndaj romëve.

Më në fund, kemi analizuar efektin e karakteristikave bashkiake në distancimin e përgjithshëm etnik të shprehur nga individët. Ne konkludojmë se ekzistojnë dy karakteristika kryesore në nivelin bashkiak që ndikojnë individualisht në distancimin etnik.

Më saktësisht, kemi vërtetuar se **sa më i lartë të jetë niveli i papunësisë, aq më i lartë do të jetë niveli i distancimit etnik, dhe sa më i lartë të jetë numri i individëve me arsim kompjuterik i bashkive, aq më i ulët është niveli i distancimit etnik.**

Prandaj, përfundimi kryesor i këtij hulumtimi është se forcimi i ekonomisë dhe rritja e nivelit të kapitalit kulturor të pasqyruar në shkrim-lexim të informacionit ka një efekt pozitiv në uljen e distancës etnike në Mal të Zi. Rekomandimi i përgjithshëm është, rrjedhimisht, **që duhet të punohet në forcimin e statusit ekonomik të bashkive, si dhe në forcimin e leximit të informacionit në bashki, sepse në këtë mënyrë mund të pritet ulje në shkallën e distancimit etnik.**

RAPORTO

EFEKATO KOMUNENGO SAR SPECIFIČNO TRUJALIPE PE ETNIKANO DISTANCIRIPE

Podgorica, april 2020.

© Centar za demokratiju i ljudska prava (CEDEM)

Editoro:

Centro baši demokratija thaj manušengere hakaja – CEDEM
(www.cedem.me)

Bašo editoro:

Milena Bešić

Autoro:

prof. dr Miloš Bešić

Nakhavno:

Elvis Beriša

Dizajno, grafika thaj printipe:

Marko Mihailović, M studio doo, Podgorica

Gaćipe:

50 kotora



Ministarstvo za ljudska
i manjinska prava

Analiza si ćerdi po ramo e projekteso „**Oснаžimo sistem za društvo jednakih prava**“ savo o Centro pale demokratia thaj manušeske hakaja - CEDEM realizirisarda po dendo dumo katar o **Ministeriumo e manušenge thaj minoritetenge hakaja**. Analiza reflek-sirinel e stavove thaj godidejipe e Centrose pale demokratia thaj manušeske hakaja thaj e autorese e Analizako, a na vi e stavove donatorese.

Sainćaripe

Metodo thaj resipa rodljaripasko	93
Bazikano nalazi efektengo thaj averčhandipe maškar e komune.....	95
Ekonomsko aktivno dizutne thaj etnikano distanciripe.....	100
Aktivno bućarne subjektora i etnikano distanciripe	104
Prosječno plata thaj etnikano distanciripe	108
Procento bibućarnengo thaj etnikano distanciripe	112
Stepeno edukaciako thaj etnikano distanciripe	116
Procento kompjutersko pismeno personora thaj etnikano distanciripe	120
Procento urbano dizutnengo thaj etnikano distanciripe	124
Prosječno phuripe pe komune thaj etnikano distanciripe.....	128
Sumarno dikhipe etnikane distanciripasko pe komunenge parametre	132

Metodo thaj resipa rodljaripasko

